



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 mars 2011
Nr. ref.: RK 83/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 33/10

Parashtrues

Aziz Sefedini

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit Nr. 03.V-165 të 17.09.2009 të
Kuvendit të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtar dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Aziz Sefedini, me banim në Prishtinë.

Vendimi i sfiduar

2. Vendimi i sfiduar nga parashtruesi i kërkesës është Vendimi Nr. 03.V-165, i nxjerrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Kuvendi) më 17 shtator 2009, i publikuar në uebfaqen e Kuvendit në po të njëjtën ditë.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 03.V-165 të Kuvendit për emërimin e dy anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit (në tekstin e mëtejme ART), në bazë të nenit 80 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Kushtetuta).
4. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës ankohet që versionet në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe të Nenit 80 të Kushtetutës nuk janë identike dhe lejojnë interpretim të dykuptimshëm lidhur me formulimin “....dhe që votojnë”. Sipas mendimit të tij, e njëjta dykuptimësi ekziston edhe lidhur me Nenin 31 të Rregullores së punës së Kuvendit.
5. Neni 80 i Kushtetutës parashikon që: “Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.”

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, Neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme Ligji), dhe Rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Parashtruesi e dorëzoi formularin e kërkesës në Gjykatë më 2 prill 2010,.
8. Më 24 gusht 2010, kërkesa iu komunikua Kuvendit, i cili deri më tani, nuk ka dorëzuar asnjë koment.
9. Më 21 janar 2011, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Kadri Kryeziu (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami, e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese Gjyljeta Mushkolaj dhe i rekomandoi Gjykatës papranuehmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 17 shtator 2009, Kuvendi votoi në seancën plenare për emërimin e dy anëtarëve të Bordit të ART-së. Prej 68 deputetëve të Kuvendit të pranishëm në seancë, 32 votuan për, 28 votuan kundër, dhe 8 abstenuan.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Parashtruesi i kërkesës pohon që Neni 6 (5) i Ligjit (2002/7) për Telekomunikacionin nuk është respektuar sa i përket mandatit të dy anëtarëve të Bordit të mëparshëm të ART-së.
12. Sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, numri prej 32 deputetëve të Kuvendit që votuan për është më i vogël se gjysma e numrit të përgjithshëm prej 68 deputetëve të

Kuvendit të pranishëm në momentin e votimit në seancën plenare, siç kërkohet me Nenin 80 të Kushtetutës.

13. Prandaj, parashtruesi i kërkesës i kërkon Gjykatës interpretim kushtetues të Vendimit Nr. 03.V-165 të Kuvendit, në bazë të Kapitullit IV, Neni 80 i Kushtetutës.
14. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës ankohet se versionet në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe të Nenit 80 të Kushtetutës nuk janë identikë dhe lejojnë interpretim të dykuptimshëm lidhur me formulimin “...dhe që votojnë”. Sipas mendimit të tij, Kushtetuta, e hartuar dhe e miratuar në përputhje me pakon Ahtisaari, nuk njeh interpretim të dykuptimshëm të tekstit në gjuhët zyrtare të Kosovës. Në lidhje me këtë, Kushtetuta ndalon formalizimin e shkeljeve të ligjeve në fuqi, paqartësinë dhe dykuptimësinë në vendimmarrje dhe gjatë zbatimit të ligjeve.
15. Parashtruesi i kërkesës pohon që e njëjta dykuptimësi ekziston edhe lidhur me Nenin 31 të Rregullores së punës së Kuvendit.

Vlerësimi i pranueshmërisë të kërkesës

16. Për të qenë kërkesa e pranueshme, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj dhe në Rregulloren e punës së Gjykatës.
17. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë, “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”
18. Është e vërtetë që vendimet e Kuvendit lidhur me emërimet dhe shkarkimet e individëve janë vendime të autoriteteve publike. Ato kanë të bëjnë me një apo më tepër të adresuar specifike dhe duhet të konsiderohen si vendime që ndikojnë në të drejtat dhe liritë e individëve të garantuara me Kushtetutë. Si rrjedhojë, ato janë objekt i vlerësimit kushtetues, d.m.th. ankesa ndaj tyre mund të parashtrohet në Gjykatën Kushtetuese.
19. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi, apo nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij se të drejtat dhe liritë e tij individuale janë shkelur me vendimin e Kuvendit (shih Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, të 18 tetorit 2010, KI 62/09, Sadik Sheme Bislimi).
20. Megjithatë, edhe nëse supozojmë se parashtruesi i kërkesës ka qenë objekt i vendimit të Kuvendit, Gjykata vëren se Neni 49 i Ligjit parashikon që kërkesa është dashur të dorëzohet brenda afatit prej (4) muajsh pas vendimit përfundimtar për këtë rast.
21. Neni 49 thotë me sa vijon:
“Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesi i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.”
22. Vendimi i sfiduar i Kuvendit është votuar në seancën plenare të Kuvendit më 17 shtator 2009, dhe është bërë publik në të njëjtën ditë. Si rrjedhojë, afati për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë ka mbaruar më 18 janar 2010, kurse parashtruesi e parashtrroi kërkesën më 2 prill 2010. Prandaj, kërkesa nuk është parashtruar me kohë, në përputhje me nenin e sipërpërmendur të Ligjit.

23. Sa i përket ankesës së parashtruesit të kërkesës se versionet në gjuhë të ndryshme të Nenit 80 nuk janë identike, Gjykata rithekson që Kushtetuta nuk parashikon “*aktio popularis*”, d.m.th. individët nuk mund të ankohen në abstrakt për legjislacionin ose aktet e Qeverisë që nuk janë zbatuar personalisht në ta përmes një mase të zbatimit (Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 7525/76, i 22 tetorit 1981).

24. Prandaj, kërkesa duhet të konsiderohet e papranueshme.

PËR KËTË ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe Rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOS


I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

Ky vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Dr. Gyljeta Mushkolaj



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani